

## Publikohet axhenda e kombetares shqiptare

nga Administrator  
E premte, 22 Prill 2016 16:21

---



Sot eshte publikuar axhenda e kombetares shqiptare qe para fillimit te europeanit deri ne ndeshjen e fundit ne grupe kunder Rumanise ne Lion te Frances.

Ekipi yne kombetar do te filloje grumbullimin me date 23 maj ne Austri. Ne qytetin Bad Waltersdorf ne oren 17:30 do te zhvillohet edhe stervitja e pare.

Me date 29 maj do te zhvillohet ndeshja e pare miqesore kunder ekipit te Katarit, por stadiumi ne te cilin do te zhvillohet kjo ndeshje akoma nuk eshte bere i ditur.

Me date 2 qershor ekipi yne do te niset per ne Bergamo te Italise, ku me date 3 qershor do te zhvilloje ndeshjen miqesore kunder Ukraines.

Me date 6 qershor kombetarja jone do te niset per ne France, ne Perros Guirec, aty ku eshte edhe rezidenca kuqezi.